



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 3062/1 prot. datë 21.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

Nr. 3530/1 prot. datë 28.04.2026

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 110, datë 21.04.2026

PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2026 – 2027
NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2026-2027 në sistemin arsimor parauniversitar të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:
 - a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 dhe mbarojnë më 18 qershor 2027.
 - b) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2026 dhe mbarojnë më 4 janar 2027.
 - c) Pushimet fillojnë më 29 mars 2027 dhe mbarojnë më 2 prill 2027.
 - ç) Provimet kombëtare të arsimin bazë zhvillohen në periudhën 21-30 qershor 2027.
2. Në arsimin e mesëm të lartë:
 - a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 dhe mbarojnë më 18 qershor 2027.
 - b) Për maturat, mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 dhe mbarojnë më 4 qershor 2027.
 - c) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2026 dhe mbarojnë më 4 janar 2027.
 - ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 7-28 qershor 2027.
3. Në arsimin profesional:
 - a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2026 për të gjitha strukturat arsimore referuar niveleve 2-4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Për vitin I dhe II të arsimin pas të mesëm niveli V i KSHK-së, mësimet fillojnë jo më vonë se java e tretë e muajit tetor 2026 dhe mbarojnë duke respektuar volumin mësimor të parashikuar në planin mësimor në skeletkurrikulat zyrtare të miratuara nga MEI.

- b) Për nxënësit klasave të 10-ta të strukturës arsimore 2+1+1, klasave të 10-ta dhe të 12-ta, të strukturës arsimore 2+2, klasave të 10-ta dhe të 11-ta të strukturës arsimore bllok 3-vjeçar, klasave të 10-ta, të 11-ta dhe të 12-ta të strukturës arsimore bllok 4-vjeçar, mësimet mbarojnë më 18 qershor 2027.
 - c) Për nxënësit klasave të 11-ta dhe të 12-ta të strukturës arsimore 2+1+1, klasave të 12-ta të strukturës arsimore bllok 3-vjeçar, klasave të 11-ta të strukturës arsimore 2+2, mësimet mbarojnë më 4 qershor 2027.
 - ç) Për të gjithë nxënësit e Maturës Shtetërore Profesionale të klasave të 13-ta për të gjitha strukturat arsimore, mësimet mbarojnë më 28 maj 2027.
 - d) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2026 dhe mbarojnë më 4 janar 2027.
 - dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit II të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK) zhvillohen në periudhën 7-18 qershor 2027.
 - e) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit IV të KShK-së për të gjitha strukturat arsimore, zhvillohen në periudhën 31 maj – 4 qershor 2027.
 - ë) Provimet e Maturës Shkollore Profesionale dhe të Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 7-28 qershor 2027.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë, dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



MINISTRI I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

